

Projekt i Organizatës Ndërkombëtare "Wus Austria"

Hapet "Kosova Case Challenge 2010"

Prishtinë, 27 janar - Organizata Ndërkombëtare "Wus Austria", edhe këtë vit synon hapjen e mundësive dhe perspektivave të reja për studentët e shkëlqyer të arsimit të lartë të Kosovës, duke i forcuar lidhjet në mes edukimit të lartë dhe punësimit, si dhe ofrimin e mundësive konkrete për punësim. Kjo do të arrihet përmes rastit sfidues të Ballkanit (Balkan Case Challenge), e cila kontribuon në rritjen e vetëdijes për

potencialin e Ballkanit, duke qenë pjesë e Evropës. Grupe të synuara të projektit janë studentët dhe kompanitë.

Drejtori i kësaj organizatë për Kosovës, But Dedaj, tha të mërkurën se kjo garë është ngjarje e rekrutimit për 140 studentë nga Evropa Juglindore. "Kosova Case Challenge 2010" është organizuar këto pesë vitet e fundit, që nga viti 2004. Çdo vit ky projekt organizohet në një dimension pak

më ndryshe se herëve të kaluara", tha Dedaj.

Koordinatorja e këtij projekti për Kosovës, Luljeta Aliu, tha se aplikimin mund ta bëjnë studentët nga Universiteti i Prishtinës (UP), si dhe të kolegjeve të akredituara në Kosovë. "Gjysmëfinalja e kësaj gare do të mbahet më datat 7, 8, dhe 9 maj të këtij viti në Prishtinë. Në këtë garë do të marrin pjesë 50 studentë, që do të trajnohen në këtë organizatë", tha

Aliu.

"Kosova Case Challenge 2010" këtë vit do të përbëhet nga tri pjesë: trajnimi për aplikues lidhur me garën e rastit studimor, gara ku fituesit nga çdo disiplinë do të selektohen për BCC që do të mbahet në Vjenë, si dhe ngjarja e rekrutimit. Kjo garë është organizuar pesë herë në Sarajevë dhe që nga viti 2006, katër herë është organizuar në Vjenë.

(d. neziri)

"LAJM"

28.01.2010